



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 877/3 prot:

Pukë, më 20.07.2023

Lënda: Dergojme vendimin e këshillit të Bashkisë Puke nr.18 datë 19.07.2023.

PREFEKTIT TE QARKUT

SHKODËR

Në zbatim të germës“a” të nenit 8 dhe pikës 2 të nenit 16 të ligjit me nr.107/2016, “Për Prefektin e Qarkut”, ju dërgojmë bashkëngjitur:

Vendimin e Këshillit Bashkiak Pukë nr.18 datë 19.07.2023 për “ Miratimin e Projektit ‘AKSIONI I PËRBASHKËT PËR MBROJTJEN E MJEDISIT – JEPA’, me Nr.Reference të aplikimit: **EuropeAid/171769/ID/ACT/MULTI**, të realizuar ndërmjet Bashkisë Pukë dhe Komunës Guci, me thirrjen e 3-të të skemës së granteve, programi ndërkuftar Mali i Zi-Shqipëri 2014-2020 nën instrumentin për Asistencën e Para-Aderimit (IPA II)”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARE

Edona HYSENAJ





REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA PUKË
KESHILLI BASHKIAK PUKE



Nr. 877/2 prot.

Pukë, më 20.07.2023

VENDIM

Nr.18 ,date 19.07.2023

PËR:

Miratimin e Projektit 'AKSIONI I PËRBASHKËT PËR MBROJTJEN E MJEDISIT – JEPA', me **Nr.Reference të aplikimit: EuropeAid/171769/ID/ACT/MULTI**, të realizuar ndërmjet Bashkisë Pukë dhe Komunës Guci, me thirrjen e 3-të të skemës së granteve, programi ndërkufitar Mali i Zi-Shqipëri 2014-2020 nën instrumentin për Asistencën e Para-Aderimit (IPA II)

Baza Ligjore: Ligji Nr.139/2015, "**Për Vetëqeverisjen Vendore**", Vendimin e Këshillit të Bashkisë me Nr.68 datë.30.12.2022 "Për Miratimin e Programit Buxhetor Afat –Mesëm 2023-2025 dhe të Buxhetit të vitit 2023 dhe Marrëveshjes së Partneritetit Nr.750 Prot, datë.04.04.2023ndërmjet Bashkisë Pukë dhe Komunës Guci, Mali i Zi.

KESHILLI BASHK

VENDOSI:

1. Miratimin e Projektit ' Aksioni i përbashkët për mbrojtjen e mjedisit – JEPA', me vlerë totale **300,420** (treqind mije e katerqind e njezet) Euro, prej të cilave **112,521** (njeqind e dymbëdhjetë mije e pesëqind e njezet e një) Euro janë fondi i akorduar nga projekti për Bashkinë Pukë, të përcaktuara me zëra specifike në kolonën 15 të buxhetit të projektit.

Kalimi i fondeve nga Koordinatori (Komuna Guci) kundrejt Bashkisë Pukë do të realizohet me 3(tre) transhe në zbatim të marrëveshjes së partneritetit ndërmjet Bashkisë Pukë dhe Komunës Guci:

- Transhi i parë me vlerë **88.209,91 Euro**
- Transhi i dyte me vlerë **13.059,88 Euro** ,
- Transhi i tretë (balanca) **11.252 Euro.**



2. Miratimin e bashkëfinancimit në vlerën **15 566.45 Euro**, të cilat do mbulohen nga kontributet në natyrë dhe Burimet Njerëzore të Bashkisë Pukë.

Për zbatimin e këtij projekt-vendimi ngarkohen :Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm , Sektori i Prokurimeve Publike dhe ai Juridik , Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe e Administrimit të Territorit , Njesia e Kordinimit të Marrëdhënieve me BE.

3. Shpallur me datë **20.07.2023**
4. Miratuar me 9 vota; Vota Pro, Vota Kunder 0, Vota Abstenim 1

SEKRETARE

Edona **HYSENAJ**



KRYETARI

Eduard **GJOKA**

